


Raport i Forumit të OZhQ-ve

Edicioni i tretë



Autor: INDEP

Programi: Zhvillim i
Qëndrueshëm

Publikuar: Qershor, 2024



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Publikim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi ose transmetohet, në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti, pa pëlqimin paraprak të botuesit. Publikimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jo komerciale.



Raiffeisen
BANK

Ky raport progresi u mundësua me mbështetjen e Raiffeisen Bank Kosova. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë botim janë të autorëve. Ato jo domosdoshmërisht pasqyrojnë opinionet ose pikëpamjet e Raiffeisen Bank Kosova.

Përmbajtja

Hyrje.....	8
Përshkrimi dhe objektivat kyçe të edicionit të tretë të Forumit Politik	9
Katër zotimet e Kosovës në implementimin e OZHQ-ve:	9
Objektivat kryesore të Forumit të OZHQ-ve në Kosovë:.....	10
Ceremonia hapëse dhe fjalët hyrëse të përfaqësuesve të nivelit të lartë politik.....	11
Tryeza diskutuese ‘ <i>Angazhimi i secilit për mirëqenien e të gjithëve</i> ’	11
Tryeza diskutuese ‘ <i>Instrumentet financiare për përshejtimin e tranzicionit energjetik</i> ’	14
Tryeza diskutuese ‘ <i>E-shërbimet dhe transformimi digjital</i> ’	15
Tryeza diskutuese ‘ <i>Investimi në arsim për gjithëpërfshirje të plotë</i> ’	16
Përfundime dhe Rekomandime	19

Hyrje

Agjenda 2030 është agjenda transformuese e kohës së fundit dhe jashtëzakonisht e rëndësishme për të gjitha shtetet që kërkojnë matjen e progresit të sektorëve të ndryshëm. Kosova vitet e fundit ka ndërmarrë iniciativa të shumta për të avancuar këtë agjendë dhe për të transformuar jetën në përgjithësi në Kosovë. Që prej vitit 2018 Kosova, ka ndërmarrë një sërë iniciativash të rëndësishme për të përmbushur këtë agjendë dhe për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë.

Agjenda 2030 paraqet një mundësi unike që shtetet të bashkohen për të adresuar sfidat e përbashkëta dhe për të ndërtuar një botë më të qëndrueshme dhe të drejtë për të gjithë. Përmes kësaj agjende, shtetet inkurajohen të ndërmarin veprime konkrete për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve të tyre dhe për të krijuar një mjedis më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.

Nisur nga viti 2018, qeveria dhe institucionet kosovare kanë investuar në projekte dhe programe të ndryshme që synojnë të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe ekonomike. Në Kosovë, zbatimi i Agjendës 2030 është një prioritet i qeverisë dhe i institucioneve të tjera relevante. Përmes investimeve në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, dhe zhvillim ekonomik, Kosova po përpiqet të përmbushë objektivat e kësaj agjende dhe të sigurojë një të ardhme më të mirë për qytetarët e saj. Në këtë kontekst, bashkëpunimi i ngushtë me partnerët ndërkombëtarë dhe zbatimi i politikave të përshtatura në kontekstin lokal janë thelbësore për arritjen e suksesit në këtë fushë.

Përshkrimi dhe objektivat kyçe të edicionit të tretë të Forumit Politik

Forumi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës (OZHQ) shërben si një platformë dinamike për nxitjen e dialogut, bashkëpunimit dhe inovacionit në ndjekjen e angazhimit të Kosovës ndaj katër prioritetëve transformuese të përshkruara në zbatimin e OZHQ-ve. Forumi është i dizajnuar për të përfshirë palët kryesore të interesit, duke përfshirë zyrtarë qeveritarë, shoqëri civile, biznese dhe partnerë ndërkombëtarë, për të ndarë njohuritë, praktikat më të mira dhe strategjitë për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me kontekstin unik të Kosovës.

Duke parë sfidat globale dhe ritmin gradual të implementimit të OZHQ-ve, Sekretari i Përgjithshëm propozoi një Agjendë Transformuese që theksonte sektorët kryesorë si arsimi, energjia, mbrojtja sociale, sistemet ushqimore, punësimi, klima, mjedisi dhe digjitalizimi. Kjo metodë gjithëpërfshirëse kërkon të shpejtojë përparimin dhe të trajtojë sfidat sistematike që pengojnë arritjen e OZHQ-ve në shkallë globale.

Në një veprim i rëndësishëm, më 18 dhe 19 shtator, Qeveria e Kosovës ndërmori katër angazhime thelbësore. Ky veprim vendimtar është i orientuar jo vetëm drejt përsheptimit, por edhe forcimit të përgjegjshmërisë në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Këto angazhime formojnë një udhërrëfyes strategjik, duke e orientuar Kosovën drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe më të barabartë duke trajtuar aspekte kritike si përfshirja sociale, energjia e rinovueshme, transformimi dixhital dhe rigjallërimi i sistemit arsimor.

Integrimi i Agjendës Transformuese me angazhimet të vendosura të Kosovës krijon një sinergji të fuqishme. Ai e pozicionon Forumin e OZHQ-ve së Kosovës në krye të nxitjes së ndryshimeve të prekshme duke nxitur një mjedis bashkëpunues ku zgjidhjet inovatore dhe nismat strategjike mund të formohen dhe të ndahen me të tjerët. Ndërsa lundrojmë në peizazhin kompleks global, ky Forum del si një fener i përgjegjësive kolektive, duke mishëruar përkushtimin e Kosovës për realizimin e OZHQ-ve dhe duke kontribuar në mënyrë domethënëse në Agjendën më të gjerë globale.

Katër zotimet e Kosovës në implementimin e OZHQ-ve:

1. Askush të mos lihet anash- Zotimi i parë fokusohet në përmirësimin e mekanizmave të mbrojtjes sociale, modernizimin e sistemeve të informacionit dhe përdorimin e identitetit digjital për të siguruar qasje të barabartë në shërbime dhe mundësi, veçanërisht për grupet e cënueshme. Forumi do të thellohet në diskutimet mbi kornizat e politikave, zgjidhjet teknologjike dhe nismat bashkëpunuese për të trajtuar sfidat shumëanëshe që pengojnë përfshirjen sociale.

2. Përsheptimi i tranzicionit drejt energjisë së ripërtitshme - Angazhimi i Kosovës për të përmirësuar qëndrueshmërinë e sistemit të saj energjetik, për të rritur pjesën e energjisë së ripërtitshme dhe për të siguruar mbrojtjen e grupeve të cënueshme përputhet me përpjekjet globale për të luftuar ndryshimet klimatike. Forumi do të shqyrtojë strategjitë për përparimin e

nismave të energjisë së ripërtëritshme, nxitjen e integritit rajonal të energjisë dhe nxitjen e partneriteteve ndër-sektoriale për të nxitur një tranzicion më të gjelbër dhe më të qëndrueshëm të energjisë.

3. Transformimi digjital - Duke adoptuar një qasje që priorizon njerëzit, Kosova synon të përshpejtojë transformimin digjiital të ekonomisë dhe shoqërisë së saj duke shfrytëzuar teknologjitë novatore dhe prirjet globale digjiitale. Forumi do të jetë një platformë për diskutimin e politikave, investimeve dhe bashkëpunimeve që nxisin digjitalizimin, duke siguruar që përfitimet e teknologjisë të arrijnë në të gjitha segmentet e popullsisë dhe të kontribuojnë në rritjen gjithëpërfshirëse.

4. Transformimi i arsimit në Kosovë - Duke u përshtatur me Agjendën Transformuese për Arsimin, Kosova është e përkushtuar të rigjallërojë sistemin e saj arsimor. Forumi do të lehtësojë diskutimet mbi praktikatat inovative arsimore, integrimin teknologjik dhe partneritetet për të siguruar që sistemi arsimor i Kosovës të evoluojë për të përmbushur kërkesat e shekullit të 21-të, duke nxitur një forcë punëtore të aftë dhe të adaptueshme.

Objektivat kryesore të Forumit të OZHQ-ve në Kosovë:

- Nxitja e bashkëpunimit ndër-sektorial dhe partneriteteve për zbatimin efektiv të OZHQ-ve.
- Ndarja e praktikave më të mira, zgjidhjeve inovatore dhe mësimëve të nxjerra mes palëve të interesuara.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të publikut mbi rëndësinë e OZHQ-ve në Kosovë.

Ceremonia hapëse dhe fjalët hyrëse të përfaqësuesve të nivelit të lartë politik

Në ceremoninë hyrëse të Forumit për OZhQ-të, të ftuar për fjalë rasti ishin: Fatmire Kollçaku – Kryetare e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, Vedat Sagonjeva – Drejtor i Zyrës për Planifikim Strategjik, Antigona Limani – Bejtullahu, Udhëheqëse e Qëndrueshmërisë dhe Komunikimit në Raiffeisen Bank si dhe Burim Ejupi – Drejtor Ekzekutiv në INDEP. Znj. Kollçaku shpalosi një historik të shkurtër të Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ). Kjo mund të ketë përfshirë temat kryesore të punës së Këshillit, kontributin e tyre në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel vendas dhe ndërkombëtar, si dhe sukseset apo sfidat që kanë përballur gjatë kohës së tyre të angazhimit.

Vedat Sagonjeva, në cilësinë e Drejtorit të Zyrës për Planifikim Strategjik, ndau me audiencën perspektivat dhe planet strategjike për të ardhmen në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm. Ndër tjerash z. Sagonjeva tregoi shkurtimisht edhe për përkushtimin e Qeverisë për të marrë përsipër 4 zotimet për zbatimin e OZhQ-ve. Tregoi një analizë të tendencave aktuale, identifikimin e sfidave të ardhshme dhe strategjitë për t'i adresuar ato.

Antigona Limani- Bejtullahu, si Udhëheqëse e Qëndrueshmërisë dhe Komunikimit në Raiffeisen Bank, ndau përvojën dhe angazhimet e bankës në fushën e qëndrueshmërisë. Znj. Limani shkurtimisht potencoi politikat dhe projektet aktuale e bankës për të përmbushur qëllimet e qëndrueshmërisë në fushën e financave dhe të biznesit.

Burim Ejupi, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv në INDEP, prezantoi kontributin dhe rolin e shoqërisë civile dhe INDEP në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Ndër tjerash z. Ejupi diskutoi projektet, partneritetet me Qeverinë dhe akterët dhe sfidat që kanë përballur gjatë punës së tyre në këtë drejtim.

Tryeza diskutuese *'Angazhimi i secilit për mirëqenien e të gjithëve'*

Në panelin e parë të Forumit ishin të ftuar znj. Fatmire Kollçaku – Kryetare e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, znj. Alberta Raci – Koordinatore e Sistemit Informativ Shëndetësor në QKMF Drenas, z. Burim Ejupi – Drejtor Ekzekutiv në INDEP, z. Artan Mustafa, Kërkues në fushën e politikës sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror .

Znj. Kollçaku ka filluar diskutimin duke përmendur cekur se tani komisioni gjithashtu ka marrë nën mbikqyrje ligjin për ndërmarrje sociale duke e cekur se promovimi i ndërmarrjeve sociale është shumë i rëndësishëm për ta përmirësuar gjendjen e mirëqenies sociale të qytetarëve. Për më tepër ajo ka shtuar se është e rëndësishme që të informohen qytetarët për të drejtat e tyre sociale dhe mënyrat se si shfrytëzimi i atyre të drejtave mund të rezultoj në një komunitet më gjithpërfshirës për të gjithë.

Sipas z. Zef Shala disa nga kriteret të cilat janë në fuqi për të marrë ndihma nga shteti, duke filluar nga pensionet deri tek grantet e bujqësisë janë të panevojshme dhe krijojnë barriera të ndryshme (p.sh. ligji për skemën pensionale e përcakton që qytetarët mund të jenë përfitues të pensioneve kontribut pagueuse të moshës nëse kanë paguar kontributet në ish-Fondin PENSIONAL të Kosovës para datës 01.01.1999 por jo më vonë se 1983). Këto barriera duhet të eliminohen. Një tjetër problem është edhe mosstimulimi i familjeve që jetojnë në fshatra të largëta të cilat hasin në barriera të ndryshme duke filluar prej procedurave të komplikuar të aplikimit për skema sociale.

Drejtoresha e Drejtorisë së parqeve dhe hapsirave publike në komunën e Prishtinës znj. Cetta ka dhënë rekomandimin që familjet me ndihma sociale duhet të delokalizohen, që do të thotë se nuk duhet që familjet që janë pjesë e skemave të ndihmës sociale të jetojnë me një lagje, por të shpërndahen edhe në lagje të tjera. Delokalizimi do të kontribuonte shumë në përfshirjen e këtyre familjeve në komunitet dhe do ta lehtësonte mundësinë për mbikqyrjen e tyre. Znj. Raci i ka cekur disa nga problemet me të cilat përballen SISH: Ministria e Shëndetësisë ka mbetur pa kompani të kontraktuara që bëjnë mirëmbajtjen e softëare-ve të SISH. Gjithashtu nuk ka kompani të kontraktuara që ta bëjnë furnizimin me printera. Por një e arritur e madhe e komunës së Drenasit është që e ka arritur objektivën e Qeverisë që deri në 2027, rreth 70% e popullsisë të jenë të regjistruar në SISH. Komuna e Drenasit e ka arritur këtë shifër. Vehbi Mujku e potencoi që së pari duhet ta kemi më të qartë se si matet varfëria. Sipas tij janë dy indikatorë të cilët e pengojnë matjen e saktë të varfërisë janë: mungesa e sigurimeve shëndetsore (nuk e dijmë se sa është mbulueshmëria e sigurimeve shëndetësore) dhe mungesa e trungut familjar (nuk dihet saktë sa anëtarë i ka një familje edhe sa te hyra i ka). Kjo e fundit ndodhë për shkak të parregullësive në lëshimin e çertifikatave të bashkësisë familjare. Problemi tjetër është që ekziston një numër i madh i skemave sociale të cilat duhet të filtrohen dhe inkoorporohen me njëra tjetrën, dhe në fund të menaxhohen/kontrollohen nga shteti.

Pjesë e panelit ishte edhe Artan Mustafa, hulumtues në fushën e politikave sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Sipas tij, luftosh varferinë nuk do të thotë se je duke e luftuar edhe pabarazine sepse mbrojta dhe gjithëpërfshirja sociale përfshinë akoma më shumë elemente se sa thjeshtë luftimi i varfërisë.

Problem parësor i politikave sociale në Kosovë është që këto politika kanë derivuar nga nga projekte të ndryshme të donatorëve të jashtëm, të cilat nuk i janë përshtatur mirë kontekstit të Kosovës. Këto projekte/modele kryesisht e kanë pasur idenë që shteti ta luftojë varfërinë ekstreme e pastaj mirëqenia sociale të ndodh në treg (dmth punësimi). Por përveç mangësive të sistemit të mbrojtjes sociale në Kosovë, z.Mustafa theksoi se ky sistem i ka edhe disa anë positive. E para, dhe ndoshta edhe elementi më i mirë, është universaliteti i mbrojtjes sociale, ku përfshihen programet si: pensionet bazike, modeli NHS i shërbimit shëndetësor, shtesat për fëmijë, kompenzimi i pushimit të maternitetit dhe kapaciteti institucional i implementimit të skemave sociale. Por fatkeqësisht këto anë positive nuk mund të tejkalojnë të metat që i ka sistemi.

Fatkeqësisht sistemi i Kosovës e ka efektshmërinë më të vogël në krahasim me shtetet e rajonit. Njëri nga rekomandimet kryesore për ta përmirësuar gjendjen aktuale ishte që reforma e sistemit

të mbrojtjes sociale duhet të vije nga brenda në mënyrë që të jetë më e kontekstualizuar. Që kjo të ndodh, reforma duhet t'i ketë katër qëllime kryesore:

- Departikularizimi (mbrojtja sociale të mos përfshij vetëm disa kategori specifike të shoqërisë) – sepse kur të drejtat e mbrojtjes sociale përfshijnë vetëm disa kategori, kjo nuk i kontribuon gjithpërfshirjes sociale
- Sistemi i mbrojtjes sociale duhet t'i kontribuoj nxitjes për përfshirjen në tregun e punës dhe solidaritetit shoqëror. Fatkeqësisht shumica e të drejtave sociale që i kemi sot mund ta demotivojnë njeriun nga puna. P.sh. nëse një familje largohet nga skema sociale në momentin që një antarë i saj fillon të punoj, atëherë kjo automatikisht e ul dëshirën për të hyrë në marrëdhënie pune. Kjo mund të përmirësohet nëse në sistem inkuadrohen të ardhurat universale baze, të cilat janë pa kushte, dmth nuk ndikohen nga ajo se nëse një person punon apo jo.
- Rritja e mbulueshmërisë dhe gjenrozitetit të të drejtave (p.sh. vetëm 20% e personave në varfëri mbulohen nga skemat sociale të parashikuara për këtë kategori, vetëm 25% e pensionistëve kanë të ardhura më të larta se 100Euro).
- Të përmirësohet e paanësia e financimit të të drejtave sociale.

Sipas Fitim Mulollit, mungojnë incentivat që i shtyjnë qytetarët të kalojnë prej skemave sociale në treg të punës (p.sh. veteranët zakonisht punojnë në formë ilegale në mënyrë që të mos e humbasin pensionin e veteranit). Gjithashtu është e nevojshme të bëhet vlerësim më i saktë i varferisë reale para se të mendojmë për strategjitë e eliminimit të varfërsisë. Kur jemi tek të dhënat, gjithashtu është e nevojshme që të mbildhen edhe të dhënat e shkaqeve të vdekjeve e pastaj këto të dhëna të përdoren për orientimin të buxhetit në blerjen e barnave për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme.

Një rekomandim këtu do të ishte që të ketë më shumë bashkëpunim me zyrën e punësimit në mënyrë që anëtarët e këtyre familjeve të kenë mundësi të ndjekin trajnime të ndryshme falas, të cilat ndryshe nuk do të kishin mundësin t'i ndjeknin për shkak të kostos financiare të tyre. Kjo do t'i aftësonte ata për treg të punës dhe rredhimisht t'i largonte nga skema sociale. Një tjetër element i rëndësishëm i gjithpërfshirjes sociale është edhe kujdesja ndaj shëndetit mendor. Fatkeqësisht gjendja e Qendrës Integruese, Rehabilituese e Të Sëmuarve Kronik Psikiatrik në Shtime lë shumë për të dëshiruar, sidomos për faktin se ka kapacitet të vogël të funksionimit. Një tjetër pikë që u përmend nga z në fjalë ishte edhe mbikqyrja e shtesave për fëmijët. Kjo do të siguronte që shtesat të shkonin aty ku duhet, në të mirë të fëmijëve. Së fundi duhet të përmirësohet infrastruktura institucionale në fushën e mirëqenies sociale.

Raporti përmbledhës për diskutimet në komisionin për Zhvillim të Qëndrueshëm ka evidentuar disa çështje kyçe të lidhura me mirëqenien sociale dhe politikën sociale në Kosovë. Ndër problemet e identifikuara përfshihen barrierat të ndryshme ligjore dhe praktike për qytetarët në nevojë, si dhe mangësitë në sistemin e mbrojtjes sociale. Në bazë të rekomandimeve të përmbledhura, është e

qartë se nevojitet një reformë e thellë e sistemit aktual për të adresuar sfidat dhe për të përmirësuar efektshmërinë dhe përfshirjen sociale.

Tryeza diskutuese *'Instrumentet financiare për përshpejtimin e tranzicionit energjetik'*

Në panelin për përshpejtimin e tranzicionit energjetik është diskutuar për rolin e luajtur nga institucionet publike dhe private për tranzicion energjetik në Kosovë. Të ftuar në këtë panel ishin: Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZrrE, Miftar Nika, Divizioni për Burime të Energjisë së Ripërtritshme në Ministrinë e Ekonomisë, Xhevat Muqa, Drejtor Ekzekutiv, Muqa Solar si dhe Labinot Jashari, Menaxher i degës regjionale të IP-së në Raiffeisen Bank, Prishtinë.

Duke filluar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme për sektorin e energjisë në Kosovë. Përmes hartimit të legjislacionit, lehtësimit të procedurave për lidhjen e impianteve të rinovueshme, aprovimit të investimeve në modernizim të infrastrukturës, organizimit të konsultimeve publike dhe licencimit të furnizuesve të rinj komercialë, ZRRE ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe efikasitetit në sektorin e energjisë.

Për më tepër përfaqësuesi i ZRRE z. Fejzullahu ka theksuar se rritja e çmimit të energjisë elektrike në të ardhmen është e pashmangshme. Faktorët që do të çojnë në rritjen e çmimit të energjisë janë taksa e Karbonit, tregtia e energjisë elektrike bazuar në Karburante Fosile: Fillimi i tregtisë së energjisë elektrike me bazë fosile nga viti 2030 do të rrisë kostot për konsumatorët, si dhe me planin për rivitalizimin e Termocentralit "TC Kosova B", pritet që ky burim i energjisë të dalë jashtë funksionit për 3 deri në 4 muaj. Gjatë kësaj kohe, energjia do të importohet, duke sjellë një kosto shtesë për konsumatorët, e cila do të reflektohet në faturën e tyre përfundimtare.

Ndër tjerash në këtë panel u diskutuan mundësitë që i ofron sektori bankar për të gjithë ata që shfaqin interes për të investuar në sisteme fotovoltaike ose në blerjen e pajisjeve eficiente të energjisë duke ofruar gjithashtu skema financiare me kushte të favorshme për qytetarët.

Ndërsa përfaqësuesit e bizneseve, në këtë rast Muqa Solar ka shprehur pakënaqësinë lidhur me kriteret dhe procedurat administrative për subvencionimin e paneleve solare nga skemat e fundit të Ministria e Ekonomisë përfshirë kriterin që shtëpia duhet të jetë e izoluar, të ketë leje ndërtimore dhe konsum minimal prej 250 kWh/muaj pasi që kjo penalizon një numër të konsiderueshëm të konsumatorëve;

Diskutime janë bërë edhe mbi procedurën e marrjes së pëlqimeve dhe lejeve për instalim të sistemit fotovoltaiik në zingjirin e institucioneve KEDS – Komunë- ZrrE – KEDS. Sipas z. Muqa, procedurat e stërzgjatura byrokratike mund të rezultojnë edhe në tërheqjen e investitorëve dhe në reduktimin e kërkesave për panele fotovotaike.

Nga zyrtari i Ministrisë së Ekonomisë u përmend edhe përfudimi i studimeve të fizibilitetit për ndërtimin e ngrohtoreve në komunën e Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Gjilanit, Drenasit, Obiliqit dhe

Zveçanit dhe kjo do të ndihmonte sadopak në uljen e konsumit të energjisë elektrike në sezonin e dimrit;

U përshkruan pakot mbështetëse për energji si dhe kriteret e thirrjeve dhe buxheti i ndarë për thirrjet respektive, ndërsa u diskutuan ndër tjera edhe mungesa e miratimit të Ligjit për Investime Strategji nga MINT, si dhe kapaciteti i baterive prej prej 170 MW, i cili është prej projekteve shumë të rëndësishme për rezervat energjetike në Kosovë.

Tryeza diskutuese ‘E-shërbimet dhe transformimi digjital’

Paneli i dytë me radhë që është udhëhequr nga znj. Donikë Beqiri, Hulumtuese në INDEP ka pasur të ftuar: z. Fatmir Belallari, Këshilltar i jashtëm për digjitalizim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Avni Kastrati, Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, z. Selim Lulaj – Përfaqësues nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, si dhe Blerta Thaci – drejtore në Open Data Kosovo.

Diskutimi filloi me shqyrtimin e sfidave që paraqet digjitalizimi për Kosovën, si dhe impaktin aktual të transformimit digjital për qytetarët dhe bizneset në vend. Z. Belallari paraqiti planet për themelimin e një agjencie për mbrojtjen kibernetike dhe zgjerimin e shërbimeve digjitale të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Po ashtu, ai ndau plane për rritjen e përqindjes së shërbimeve publike të digitalizuara, me synimin që 65% e tyre të jenë të disponueshme online deri në vitin 2027.

Në vijim, diskutimi u fokusua në tre elementet kryesore që ndikojnë në transformimin digjital: pagesat digjitale, identiteti digjital, dhe shkëmbimi i të dhënave. Këto aspekte u cilësuan si thelbësore për përshpejtjen e procesit të digjitalizimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Z. Kastrati nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ndau sfidat që përballon agjencia në lidhje me mungesën e personelit dhe projekteve të mëdha që bazohen në të dhënat e tyre nga burime administrative, anketat, dhe aktivitetet periodike si regjistrimi i popullsisë.

Në vazhdim, Z. Lulaj, përfaqësues nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, prezantoi rolin e institucionit në përkrahjen e qeverisë së digjitalizimit në nivelin qendror dhe lokal. Ai shpjegoi progresin e platformës E-Kosova dhe numrin e shërbimeve elektronike të ofruara, duke theksuar rritjen e përdorimit të tyre nga qytetarët.

Z. Belallari vuri në dukje objektivin për të arritur një nivel minimal të digjitalizimit për 90% të ndërmarrjeve në Kosovë deri në vitin 2030. Ai identifikoi kostot dhe mungesën e njohurive si sfidat kryesore për këto ndërmarrje, duke paraqitur një sërë veprimesh të planifikuara për të ndihmuar në përmirësimin e aftësive digjitale dhe në lehtësimin e procesit të transformimit digjital për to.

Në fund të diskutimit, u bë thirrje për bashkëpunim të ngushtë me sektorin e diasporës, si një burim potencial i ekspertizës dhe resurseve në fushën e teknologjisë informative dhe komunikative (ICT).

Tryeza diskutuese ‘Investimi në arsim për gjithëpërfshirje të plotë’

Paneli i radhës që ka diskutuar investimin në arsim për gjithëpërfshirje të plotë ka pasur të ftuar: z. Avni Rexha- Zv. Drejtor i Departamentit për Arsim Parauniversitar, MASHT, znj. Edona Shotani-Zyrtare për çështje psikologjike, DKA, Vushtrri, z. Petrit Tahiri- Drejtor Ekzekutiv në Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), si dhe është moderuar nga Agon A. Ahmeti, Drejtor Ekzekutiv në ETEA.

Duke filluar nga problematika e braktisjes së shkollimit obligativ në Kosovë ku përfaqësuesi i MASHT shpalosi punën e ministrisë në këtë fushë, korniza legjislative në të cilën mbështetet puna e ministrisë dhe komunave bazohet në Strategjinë për Arsim 2022 – 2026, ku një shtyllë e veçantë i kushtohet gjithëpërfshirjes në arsim. Ministria gjithashtu bashkëpunon ngusht me UNICEF si dhe me organizata të shoqërisë civile si KEC. Në Kosovë u theksua se nuk ka pasur ekipe për parandalimin e braktisjes së shkollimit, dhe ministria ka intervenuar duke angazhuar 41 ekipe në shkolla të mesme të larta dhe 110 ekipe për arsim të mesëm të ulët në 15 komuna.

Në aspektin e punës në nivelin lokal, vlen të theksohet se ministria në bashkëpunim me UNICEF ka zhvilluar plane komunale të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës në të gjitha komunat e Kosovës. Nga ministria janë identifikuar 985 fëmijë të rrezikuar për braktisje të shkollimit, ndërsa 340 të tjerë janë kthyer në shkolla përmes metodave të këshillimit, bisedimit me familje dhe shkollën.

Në nivelin kombëtar, përfshirja e nxënësve të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian është rreth 31% në arsimin e mesëm të lartë, e cila sipas planit tentohet të ngritet në 50%. Ndërsa në edukimin parashkollor përqindja e përfshirjes së fëmijëve RAE bie në 6.7%. Niveli i përgjithshëm i përfshirjes së nxënësve është 15% në të gjithë arsimin parashkollor. Qeveria synon arritjen e përfshirjes 30% në arsim parashkollor, vlerë kjo që është shumë e arritshme me angazhim të institucioneve përgjegjëse. Institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile po punojnë në këtë drejtim duke ofruar bursa për fëmijët e komunitetit RAE për të siguruar vazhdimsi të shkollimit.

Roli i pandemisë dhe ndikimi i saj në arsim është i dukshëm edhe tani. Ndikimi më i madh është vërejtur në arsimin parafillor (mosha 5 – 6 vjeç) ku para pandemisë pjesëmarrje shënonte vlerën 90% ndërsa pas pandemisë 87%. Para 6 muaj është aprovuar ligji që i jep fuqi institucioneve për të investuar në përfshirjen e fëmijëve në arsim parafillor.

Komuna e Vushtrisë specifikisht ka bashkëpunim të mirë me nivelin qendror të qeverisjes. Në këtë komunë momentalisht ka psikolog në cdo shkollë të madhe, gjithsej 8, 12 asistent për nxënësit me nevoja të veçanta, 4 polic civil, 31 ekipe kundër abuzimit, 10 ekipe të ndërmjetësimit si dhe 37

ekipe për parandalimin e braktisjes së shkollimit. Nga 37 shkolla në komunë, 35 janë të pajisura me kamera dhe 36 kanë qasje në internet. Për të ndikuar tutje në parandalimin e braktisjes, komuna ka bashkëpunuar me bizneset lokale duke ofruar mësimin dual, që ka ndikuar shumë në rënien e mungesave të nxënësve të komunitetit RAE në arsimin e mesëm të lartë.

Komuna gjithashtu ka linja të transportit për fëmijë që jetojnë në largësi nga shkolla për të lehtësuar pjesëmarrjen në orë mësimore. Si masë lehtësuese komuna bën subvencionimin e familjeve me kushte të rënda ekonomike, si dhe pajisja e tyre me materiale didaktike. Kjo mbështetje është bërë përmes marrëveshjes së bashkëpunimi të komuna ka lidhur me biznese lokale në mënyrë që ti pajisin fëmijët me kushte më të vështira ekonomike me pajisje didaktike. Gjithashtu këto marrëveshje kanë shërbyer për të praktikuar mësimin dual, specifikisht tek shkollat e mesme profesionale sepse nxënësit me rrezikshmëri më të lartë të braktisjes së shkollimit janë në këtë nivel për shkak të angazhimit të tyre në punë. Mësimi dual u ka mundësuar që në të njëjtën kohë të kryejnë edhe praktikën e tyre edhe të vijojnë mësimin duke ndikuar në uljen e mungesave në shkollë.

Në nivelin qëndror ministria çdo vit ndan buxhet rreth 200.000 EUR për mbështetjen e organizatave jo-qeveritare që drejtojnë qendrat mësimore që mbështesin nxënësit e komunitetit RAE. Gjithashtu ofron 400-500 bursa në vit për nxënësit e komunitetit RAE për ti motivuar ata në vazhdimësinë e procesit shkollor. Përfshirja e fëmijëve në edukim të hershëm shënën vlerën 19.6%. Ministria ka arritur të hartoj dhe miratoj Ligjin për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, ku në ligj parashihet edhe forma e organizimit të institucioneve të edukimit parashkollor, si ato publike, private dhe organizimi publiko-privat. Qeveria ka premtuar ndërtimin e 160 qerdheve përgjatë mandatin, objektivë kjo thujse e paarritshme. Ndërtimi i qerdheve bëhet në nivel lokal, dhe kërkesat e komunave për qerdhe kanë qenë jo të plota. Prandaj ka pasur problem me ndarjen e parcelave për ndërtimin e qerdheve. MASHT-i ka filluar ndërtimin e 19 institucioneve parashkollore për vitin 2024, dhe ka planifikuar ndërtimin e 10 të tjerave në vitin 2025. Poashtu po punohet në adaptimin e shkollave në institucione parashkollore, ku deri tani ka përfunduar adaptimi i 3 shkollave në kopshte, në 2024 edhe 7 shkolla të tjera do të adaptohen. Ndërsa përmes fondeve të IPA do të bëhet ndërtimi i 6 institucioneve parashkollore, që në total në dy vitet e ardhshme pritet ti kemi 45 institucione parashkollore të reja në Kosovë.

Sipas pikëpamjes së shoqërisë civile problemi nuk qëndron në rritjen e buxhetit për arsim, mirëpo shfrytëzimi të jetë me efikas, sepse në vendin tonë rreth 5% e GDP shkon në arsim dhe kjo vlerë është edhe në vendet e rajonit. Numri i nxënësve sipas ASK do të bie dhe rritja e buxhetit është e panevojshme. Çdo vit ndahen mjete për zhvillim profesional të mësimdhënësve, në vitin 2015 në zhvillim të vazhdueshëm profesional kanë marrë pjesë rreth 54% e mësimdhënësve, ndërsa në vitin 2023 kjo përqindje bie në 24%. Pas pandemisë dhe organizimit të grevave ka rënë dukshëm motivimi i mësimdhënësve, sepse sistemi i licencimit i cili ka strukturë të mirë nuk është zbatuar në mënyrën e duhur dhe mësimdhënësit nuk janë vlerësuar për avancimin e tyre.

Tani është bërë edhe kurrikula për edukim të hershëm dhe ka filluar pilotimi i saj. Nga vlerësimi në teren është evidentuar se edukatorët e rinjë nuk janë të përgaditur për punë, dhe kanë mungesë

të aftësive praktike për të individualizuar planet e aktiviteteve që derivojnë nga kurrikula. Kurrikulat nuk janë inclusive, dhe aktivitetet brenda saj nuk i marrim parasysh nxënësit me nevoja të vecanta. Ndërsa në qendrat me bazë në komuniteti, etnitë e ndryshme nuk bashkohen, është rasti në gjilan ku fëmijët serb e zhvillojnë mësimin vec dhe shqiptarët e zhvillojnë vec.

Përfundime dhe Rekomandime

- Eliminimi i Barrierave Ligjore dhe Praktike: Kërkohej eliminimi i kufizimeve dhe barrierave ligjore që pengojnë qasjen e qytetarëve në nevojë në ndihmat sociale. Kjo përfshin qasje të lehtësuara dhe procedura më të thjeshta për aplikime për ndihma sociale. Delokalizimi i Familjeve me Ndihma Sociale: Rekomandohet që familjet që marrin ndihma sociale të shpërndahen nëpër lagje të ndryshme për të promovuar përfshirjen sociale dhe për të lehtësuara mbikqyrjen e tyre.
- Mbrojtja Sociale dhe Përfshirja në Tregun e Punës: Kërkohej zhvillimi i politikave që inkurajojnë qytetarët të kalonin gradualisht nga skemat sociale në tregun e punës, duke përfshirë mbajtjen e ndihmave sociale për një periudhë tranzicioni pas fillimit të punës.
- Reforma e Sistemit të Mbrojtjes Sociale: Rekomandohet një reformë e thellë e sistemit të mbrojtjes sociale për të adresuar mungesat aktuale dhe për të siguruar një mbulim më të gjerë dhe më të drejtë për të gjithë qytetarët. Mbrojtja e Shëndetit Mendor dhe Përmirësimi i Infrastrukturës Sociale: Kërkohej një fokus më i madh në kujdesin ndaj shëndetit mendor dhe përmirësimi i infrastrukturës sociale, duke përfshirë qendra rehabilituese dhe trajnime për familjet në nevojë.
- Rritja e Transparencës dhe Efektshmërisë së Financimeve: Nevojitet një përmirësim i transparencës dhe efektshmërisë së financimeve në politikat sociale, përmes një mbikëqyrje të përmirësuar dhe të rregulluar të buxhetit.
- Të thellohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve kyçe për marrjen e lejeve si ZRRE, MMPHI dhe ME dhe zyrtarëve të nivelit komunal. Përfshirja aktive e përfaqësuesve të zyrtarëve në nivel komunal dhe informimi i tyre në kohë lidhur me ndryshimet e pësuara në kornizën ligjore sa i përket sigurimit të lejeve dhe licencave përkatëse, paraqet një element thelbësor për zhvillimin e sektorit të energjisë. Kjo gjithëpërfshirje, do të kontribuonte në një proces më transparent dhe më të përgjegjshëm në planifikimin dhe zbatimin e politikave dhe masave në sektorin e energjisë;
- Të promovohet një treg më konkurrues me qëllim të diversifikimit të burimeve energjetike dhe sigurimit të cmimit të energjisë elektrike me një tarifë më të përballueshme për konsumatorët e mëdhenjë. Hapja e tregut falë marrëveshjeve me Shqipërinë dhe Maqedoninë, inkurajon investime afatgjata më se tre vjet duke siguruar një interes të qëndrueshëm për aktorët e jashtëm.

- Institucionet qeveritare duhet të inkurajojnë bashkëpunimin me bankat vendore për të promovuar investimet në panele solare. Në mënyrë që konsumatorët të shfaqin interes për investime në sektorin e energjisë së ripërtritshme, është e rëndësishme që bankat të ofrojnë cmime dhe kthim të investimeve më se 15% (aq sa ofrohet tashmë). Përfshirja e bankave dhe bashkëpunimi me qeverinë do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të përshtatshëm edhe ekonomikisht më të përballueshme, duke kontribuar njëkohësisht në përmirësimin e politikave të gjelbërta.
- Të trajnohen përfaqësues të fushave të ndryshme inxhinierike, të financave dhe politikave mjedisore. Këto ekipe duhet të kenë njohuri të thella në teknologjitë e energjisë së diellit, të erërave, dhe burimeve të tjera të ripërtërishme, si dhe të jenë në dijeni të legjislacionit dhe politikave aktuale të energjisë dhe mjedisit. Krijimi i ekipave të specializuara në këtë drejtim, ndihmon sigurimin e një këshillimi cilësor dhe të përshtatshëm për bizneset që dëshirojnë të hyjnë në këtë sektor në mënyrë më të qëndrueshme, duke ju kursyer kohë palëve të përfshira në të njëjtën kohë.
- Të digjitalizohet procedura e aplikimit për leje nën 10 MW. Krijimi i kësaj platforme duhet të ofrojë një proces të thjeshtë dhe efikas për aplikim për leje të projekteve me një kapacitet nën 10 MW, duke reduktuar nevojën për të shkuar personalisht në zyrat e ZRRE-së. Përdorimi i kësaj platforme do të zvogëlojë koston dhe kohën e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit, duke u siguruar që të gjithë aplikuesit të trajtohen barabartë. Përveç kësaj, digjitalizimi do të lehtësonte aksesin për aplikuesit, duke e bërë procesin më transparent dhe të qasshëm nga distanca.
- Të hartohet një politikë tatimore e favorshme për produktet që kanë për qëllim promovimin e energjive të ripërtritshme. Duke prezantuar reforma të përshtatshme tatimore, qeveria mund të inkurajojë prodhimin vendas dhe të kontribuojë në nxitjen e konkurrencës së shëndetshme në tregun vendor. Kjo do të ndihmonte në lulëzimin e ekonomisë vendore dhe në krijimin e vendeve të reja të punës si dhe do të kontribuonte në arritjen e targeteve të përcaktuara në Strategjinë e Energjisë, me kusht që produktet/energjinë e prodhuar të jenë zero karbon.
- Të decentralizohet përgjegjësia për aprovimin e projekteve të energjisë së ripërtërishme me qëllim të përshtatshmit të procedurave për implementimin e projekteve të reja në sektorin energjetik. Ky decentralizim do të ndihmonte në zvogëlimin e byrokracisë së tepërt si dhe të pritjeve të panevojshme të investitorëve. Shpërndarja e përgjegjësisë gjithashtu ndikon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga autoritetet vendimmarrëse.

- Ndërtimi i një agjencie për mbrojtjen kibernetike për të parandaluar sulmet në infrastrukturën digjitale, si dhe investime në zhvillimin e platformave dhe aplikacioneve të përdorshme për qytetarët dhe bizneset, duke ndikuar kështu në shtimin e shërbimeve online për të rritur përqindjen e shërbimeve publike digjitale deri në 2027.
- Trajnime dhe programe zhvillimi për të rritur aftësitë digjitale të punonjësve në sektorin publik dhe privat, si dhe ndërtimi i një qendre trajnime dhe inovacioni digjital për të inkurajuar zhvillimin e aftësive në fushën e ICT. Përmirësimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit me sektorin e diasporës për të shfrytëzuar ekspertizën dhe burimet në fushën e teknologjisë informative dhe komunikative.
- Një ndër rekomadimet e dhëna gjatë diskutimit ishte edhe shtimi i fushatave të informimit dhe sensibilizimit për përfitimet dhe rëndësinë e digjitalizimit për qytetarët dhe bizneset, si dhe krijimi i një portali që ofron këshilla dhe udhëzime për ndërmarrjet për të kryer transformimin digjital, si dhe fokusimi në promovimin e pagesave dhe shërbimeve online për të rritur përdorimin e tyre nga publiku.
- Institucionet shtetërore duhet të punojnë në rritjen e pjesëmarrjen së fëmijëve në arsimin parafillor dhe të arrihet vlera e ngjashme me arsimin fillor prej 100%. Niveli lokal i qeverisjes duhet të parashoh bashkëpunimin me biznese lokale për të ofruar mësimin dual për nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollimit të mesëm të lartë, si dhe komunat duhet të ofrojnë masa lehtësimi për nxënësit që vijnë nga familje me kushte më të rënda ekonomike për të siguruar pjesëmarrjen e tyre të vazhdueshme në procesin mësimor.
- Ndër rekomandimet tjera është praktikimi i mësimi hibrid në rastet kur digjitalizimi i plotë është i paarrtshëm, duke përdorur mjete digjitale si mbështetje e metodave tradicionale të mësimdhënies. Shtrirja e internetit nëpër shkolla duhet të përmirësohet për të lehtësuar përdorimin e teknologjisë gjatë procesit mësimor. Procesi i pajisjes së shkollave me pajisje të teknologjisë informative duhet të përshpejtohet për të qenë në linjë me objektivat e strategjisë së arsimit. Mësimdhënësit duhet të trajnohen për përdorimin e pajisjeve teknologjike të cilat do të jenë të domosdoshme gjatë procesit të digjitalizimit. Ndër tjerash u diskutua që platforma shkollat.org duhet të ketë një trup mbështetës në nivel qendror apo lokal për të iu lehtësuar mësimdhënësve përdorimin e kësaj platforme. Si dhe është tepër e nevojshme që të bëhen fushata ndërgjegjësuese për publikun, më saktësisht prindërve për përdorimin e pajisjeve teknologjike si mjet i mësimi për fëmijët dhe jo për argëtim.
- Ndër tjerash institucionet tona duhet të përkushtohen në zbatimin e Strategjisë për Arsim, pasi që objektivat e saj janë shumë konkrete dhe të arritshme duke siguruar mirëqenie dhe gjithëpërfshirje në arsim. Investimi në zhvillimin profesional të mësimdhënësve është i

nevojshëm, specifikisht në aspektin e inkorporimit të metodave gjithëpërfshirëse gjatë orës mësimore. Trajnimet e mësimeve duhet të jenë më specifike dhe që i përgjigjen kohës dhe kërkesave të fushës. Poashtu, avancimi i infrastrukturës shkollore, që ambienti i shkollës të jetë përkrahës dhe motivues për fëmijët. Edukatorëve të rinjë duhet të u jepet qasje në institucione gjatë praktikës së tyre gjatë studimeve, për të fituar aftësitë praktike. Ndër rekomandimet e fundit por jo më pak të rëndësishme është që duhet të punohet që të inkurajohet diversitetin etnik nëpër klasa.

Ky punim u botua me mbështetjen e Raiffeisen Bank Kosova. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të INDEP-it, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo bordit.



Mbështetur nga:



Zbatuar nga:

